



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE ME DONATORËT

Nr. 6227 prot.

Himarë, më 31.08 . 2026

Njoftim për shprehje interesi për pjesëmarrje në “Forum in e Partneritetit Mjedisor” (FPM)

Bashkia Himarë fton të gjithë grupet e interesit/individët e interesuar të aplikojnë në kuadër të **thirrjes për shprehje interesi për pjesëmarrje në “Forum in e Partneritetit Mjedisor (FMN)”**, që do të zbatohet në Himarë me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Forum i Partneritetit Mjedisor i cili do të pilotohet për herë të parë në Bashkinë Himarë do të themelohet në kuadër të projektit "Forcimi i kapaciteteve të qeverisjes vendore dhe përmirësimi i qeverisjes mjedisore në Shqipëri - faza II", si një platformë shumëpalëshe me grupet e interesuara për përforcimin e qeverisjes mjedisore përmes dialogut, bashkëpunimit dhe veprimit të përbashkët.

Forum i synon të rrisë koordinimin dhe bashkëpunimin midis institucioneve publike, shoqërisë civile, akademisë, bizneseve dhe komuniteteve lokale për të identifikuar së bashku prioritetet mjedisore, për të zhvilluar zgjidhje praktike dhe për të mbështetur vendimmarrje më të koordinuara mjedisore në Himarë.

Si një nga bashkitë bregdetare me rritjen më të shpejtë në Shqipëri, bashkia e Himarës përballlet me presione të konsiderueshme sezonale që lidhen me zhvillimin e turizmit, duke përfshirë:

- menaxhimin e mbetjeve;
- mbrojtjen e ekosistemeve bregdetare dhe detare;
- presionet e përdorimit të tokës dhe ndërtimit;
- balancimin e zhvillimit ekonomik me qëndrueshmërinë mjedisore.

FPM-ja synon të krijojë një platformë të vazhdueshme për dialog, bashkëpunim dhe zgjidhje të përbashkët të problemeve që mbështet zhvillimin e gjelbër dhe ekonominë qarkulluese.

STRUKTURA E QEVERISJES SË EPF-SË – BASHKIA HIMARË



Përzgjedhja

Kjo thirrje për shprehje interesi është e hapur për grupet e interesit të përfshira në qeverisjen mjedisore, si institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile, individët e angazhuar aktivisht ose të interesuar në qeverisjen mjedisore të Bashkisë Himarë.

Më konkretisht, grupi i synuar i anëtarëve të FMM-së targeton grupet e interesit të përcaktuara në mënyrë indikative si më poshtë:

Grupet e interesit

Aktorët Kryesore

Institucionet Publike	Bashkia Himarë; Agjencia Rajonale e Mjedisit; Agjencia Rajonale e Zonave të Mbrojtura;
Organizatat e Shoqërisë Civile	Organizatat e Shoqërisë Civile Mjedisore, Grupe Rinore dhe grupime të tjera komunitare.
Sektori Privat	Operatorët turistikë (hotele, restorante); bizneset lokale; zhvilluesit e pasurive të paluajtshme; ndërmarrjet e ekoturizmit mjedisor, grupime të prodhuesve, fermerë, dhe grupe të tjera interesi.
Komuniteti lokal	Banorët; udhëheqësit e komunitetit; peshkatarët; pronarët e bizneseve të vogla
Akademia / Eksperte	Universitet; ekspertë mjedisorë; kërkues

Pjesëmarrja në Forumin e Partneritetit Mjedisor është vullnetare. Aplikantët me ekspertizë ose interes të demonstruar në fusha të tilla si ruajtja e biodiversitetit, ekosistemet detare dhe bregdetare, menaxhimi i mbetjeve, ekonomia rrethore, turizmi i qëndrueshëm, edukimi mjedisor, zonat e mbrojtura, burimet natyrore, qëndrueshmëria ndaj klimës ose qeverisja mjedisore inkurajohen veçanërisht të aplikojnë.

Procedura e aplikimit

Pjesëmarrësit e interesuar mund të aplikojnë për të marrë pjesë në Forumin e Partneritetit Mjedisor (PPM) duke dorëzuar:

- një Letër Interesi (maksimum një faqe), ku të shpjegojnë motivimin për t'iu bashkuar Forumit të Partneritetit Mjedisor;
- nëse është e nevojshme, 1-2 sugjerime ose rekomandime për modalitetin e zbatimit ose çështjet prioritare mjedisore që Forumi duhet të trajtojë.

Aplikimet duhet të dërgohen elektronikisht në adresën e mëposhtme:

info@himara.gov.al

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **11 shtator 2026**, ora 17:00.

FORUMI I PARTNERITETIT MJEDISOR

Bashkia Himarë

Shprehje Interesi

Grupimi që përfaqëson:

Kontakt [E-mail/tel]:

Vendbanimi:

Motivimi:

Sugjerime (Nëse ka)

Emër & mbiemër

(Firma)

Shënim: Procesi i përzgjedhjes së anëtarëve të Forumit të Partneritetit Mjedisor (FPM) do të bazohet në pesë kritere vlerësimi: motivimi për pjesëmarrje, lidhja me çështjet mjedisore, Himarën dhe komunitetin, kontributi i mundshëm në Forum dhe cilësia e sugjerimeve. Përzgjedhja finale do të përfshijë një përbërje të balancuar të Forumit për sa i përket grupeve të interesit, gjinisë, moshës dhe territorit.

**KRYETARI
VANGJEL TAVO**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI
Erifili Berberi**



Konceptoi: E. Husi

Pranoi: K. Fikaj

Miratoi: V. Avdullaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PROJEKTEVE ME DONATORËT ✓

Nr. 6227/prot.

Himarë, më 31.08. 2026

Lënda: Për publikim në faqen zyrtare të Bashkisë Himarë.

**DREJTORISË SË BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHERBIMEVE
DIGJITALE**

KËTU

Në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet Bashkisë Himarë dhe OSBE-së për ngritjen e forumit të partneritetit mjedisor, bashkëlidhur po ju përcjellim njoftimin për shprehje interesi, me qëllim publikimin në faqen zyrtare të Bashkisë Himarë.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin!

DREJTORI

Valbona Avdullaj

Konceptoi: E.Husi

Pranoi: K.Fikaj